



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBBIMIN CIVIL

ORGANIZATËS “SHQIPËRIA BËHET”

Rruga: “Jeronim De Rada”

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 34 prot., datë 08.02.2024, protokolluar me tonën nr. 934 datë 09.02.2024, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, kërkonti informacion në lidhje me punonjësit e administratës publike dhe proceset gjyqësore për largimin e tyre, ju bëjmë me dije se:

Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 3, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al.

Në lidhje me kërkesat tuaja sqarojmë se, në pikën 2, të nenit 7, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcaktohen detyrat e Departamentit të Administratës Publike (DAP). Më konkretisht në këtë dispozitë parashikohet se:

“2. DAP-i ka këto detyra:

- a) përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave shtetërore në shërbimin civil;*
- b) përgatit projekt-aktet ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil;*
- c) mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;*
- ç) përgatit mendim për çdo projekt-akt të propozuar nga institucionet e tjera që ka të bëjë me marrëdhëniet e punësimit në administratën publike;*
- d) miraton dhe ndjek zbatimin e programeve të trajnimit në shërbimin civil;*
- dh) përgatit planin vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore;*
- e) përfaqëson, së bashku me Ministrinë e Financave, Këshillin e Ministrave në negociatat dhe konsultimet për kushtet e përgjithshme të punës në shërbimin civil me sindikatat ose përfaqësuesit e nëpunësve civilë;*
- ë) administron Regjistrin Qendror të Personelit;*
- f) mbështet dhe siguron këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji;*
- g) përgatit udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;*
- gj) i paraqet Kryeministrit, me propozim të institucioneve të administratës shtetërore, strukturën dhe organikën e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë;*
- h) në përputhje me legjislacionin në fuqi, harton dhe bashkëpunon për strukturën e pagave për nëpunësit dhe punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore;*
- h/1) harton dhe miraton rekomandimet për politikën e trajnimeve të nëpunësve civilë.*

i) ushtron çdo kompetencë të dhënë nga ky ligj apo në bazë të tij.”

Për më tepër, në gërmën “a” dhe “f”, të pikës 1, nenit 4, të këtij ligji, përcaktohet se:

“a) “Institucion i administratës shtetërore” është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit .

f) “Njësi përgjegjëse” është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.”

Për sa më sipër, referuar dispozitave të sipërcituara ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit, ju bëjmë me dije se DAP-i është njësi përgjegjëse vetëm për administratën shtetërore, përbërja e së cilës përcaktohet më lart. Në çdo rast, fusha e veprimtarisë së institucionit shtrihet vetëm në shërbimin civil.

Për pyetjet 1-2

DAP në cilësinë e njësisë përgjegjëse për administratën shtetërore publikon në mënyrë periodike, numrin e nëpunësve të emëruar në pozicione të shërbimit civil , si dhe numrin e nëpunësve civilë të cilëve u ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil, të dhëna të cilat i gjeni në rubrikën “Plotësimi i pozicioneve vakante në shërbimin civil” dhe në rubrikën “Lirimet” në Raportet Vjetore të Departamentit të Administratës Publike, që publikohen në faqen zyrtare të institucionit, në linkun: <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>

Pyetja 3

Për sa i përket kërkesës tuaj për numrin e punonjësve të administratës publike për vitet 2000-2023, referuar dispozitave të sipërcituara ligjore ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e institucionit, ju bëjmë me dije se DAP nuk e disponon këtë informacion. Këto të dhëna mund të disponohen nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, e cila është ministria përgjegjëse që menaxhon buxhetin vjetor në Republikën e Shqipërisë.

Pyetjet 4-6

Në lidhje me kërkesat tuaja për proceset gjyqësore të humbura nga administrata publike ndër vite dhe efektet financiare të krijuara ju sqarojmë se, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për administratën shtetërore dhe si rrjedhojë e detyrimeve të përcaktuara për njësitë përgjegjëse në nenin 66/1 i ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar DAP-i mbikëqyr zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në institucionet e administratës shtetërore, vetëm për sa i përket detyrimit për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë dhe jo për detyrime të tjera, si ato financiare.

Në kuadër të këtij detyrimi dhe bazuar në informacionin e përcjellë nga vetë institucionet që janë pjesë e administratës shtetërore, DAP publikon në mënyrë periodike të dhëna mbi numrin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të nëpunësve, numrin e vendimeve të zbatuara, si dhe numrin e çështjeve gjyqësore që janë në proces shqyrtimi. Këto të dhëna i gjeni në rubrikën “Vendimet Gjyqësore”, në Raportet Vjetore të DAP-it, të sipërcituara. Ju sqarojmë se, për sa i përket numrit të çështjeve gjyqësore të cilat janë në proces shqyrtimi, DAP-i administron vetëm të dhënat e atyre proceseve ku ka qënë dhe është palë ndërgjygjëse.

Ritheksojmë se, institucioni jonë nuk disponon të dhëna në lidhje me çdo proces gjyqësor që lidhet me largimet nga administrata publike. Ashtu si përmendëm më sipër, DAP-i disponon të dhëna vetëm për ato procese gjyqësore ku është vetë palë ndërgjygjëse dhe për vendime gjyqësore të formës së prerë, ku përcaktohet detyrimi i rikthimit të nëpunësit në detyrë në shërbim civil. Këto të dhëna janë mbledhur nga raportimet e vetë institucioneve të administratës shtetërore, bazuar në detyrimet e parashikuara në nenin 66/1 të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe Urdhrin 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të shërbimit civil”.

Si përfundim ju sqarojmë se, se të gjitha të dhënat që DAP disponon në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana juaj janë publikuar në raportet vjetore të DAP, në përputhje me detyrat e kompetencat e institucionit, të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil ndër vite. Për sa i përket raportit vjetor të vitit 2023, ju informojmë se ai është në proces përgatitjeje dhe me përfundimin e tij, do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

